



BASHKIA HAS

[Të dhënat për projektet, nismat dhe veprimtarite e bashkisë në kuadrin e integrimit në BE](#)

Bashkia Has ka ngritur strukturën e integrimit evropian që në vitin 2018 struktura e cila trajtonte çështjet e integrimit evropian dhe ndihmës së huaj dhe njëkohësisht koordinonte punën për projekte të BE. Me vendim të Këshillit Bashkiak Has Nr. 95 Date 22.12.2022 kjo strukturë u shtua me 1 specialistë me emërtimin Specialist për Njësine e Integrimit Evropian, Migracionit dhe Diasporës. Duke parë nevojën për rritje kapacitetesh në këtë strukturë me vendim të Këshillit Bashkiak Has Nr. 95 Date 22.12.2022, zyres së njësisë së Integrimit Evropian iu shtua dhe një specialist tjetër me emërtimin Specialist për Koordinimin Evropian, Migracionin dhe Diasporën ku përveç çështjeve të integrimit, specialisti do mbulonte dhe çështjet e migracionit dhe diasporës.

Puna ka nisur ngushtë me projektin “Bashkitë për në Evropë” i cili ka mbështetur bashkitë dhe strukturat e integrimit evropian në këto bashki për t’u fuqizuar në informin dhe qasje në fondet e BE-se, rritjen e kapaciteteve të stafeve të Njesive të Integrimit Evropian dhe mbështetjen për aktivitete të vogla.

Njësia e Integrimit evropian ka realizuar takime të here pas hershme me të rinjtë ku janë diskutuar tema të ndryshme në lidhje me BE, janë informuar mbi politikën e BE-së me anë të workshop-eve interaktive, aktivitete mbi javën e Evropës mbi diversitetin, gjithëpërfshirjen, të drejtat e njeriut etj.

Kemi pasur bashkëpunim edhe me UNICEF Albania i cili na ka mbështetur me ekspertë të fushës për trajnimet dhe aktivitetet që kemi zhvilluar. Gjithashtu kemi pasur bashkëpunime dhe vizita studimore të realizuara me disa ambasada të huaja si dhe projekte ndërkufitare me Kosovën.

Përsa i përket projekteve Njësia e Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj ka aplikuar gjithsej në 6 thirrje për projekte lidhur me programet IPA II, Europe Aid, EU for socio-economic development, European Union in Albania, Programi i Sigurisë Njerëzore të Ambasadës së Japonisë, UEFA foundation for children, Agjencia Kombëtare e Rinisë etj.

Gjithashtu Bashkia Has ka marrë pjesë në vizitën studimore në Kinë me temë ‘Seminar on Agriculture and Rural Development for Developing countries’ si dhe në Mavrov në lidhje me projektin mbi mbarëshkrimin e pyjeve.

Kemi pasur dhe kemi bashkëpunime të ngushtë me shkollat 9-vjecare dhe të mesme të qytetit ku kemi zhvilluar takime dhe trajnime me nxënësit dhe të rinjtë janë informuar fizikisht dhe nëpërmjet adresave zyrtare të Bashkise mbi cdo thirrje apo mundësi të studimit në shtete të evropës, mundësi për bursa, proceset e aplikimit etj.